



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 43, datë 23.07.2025

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, SUKTH, MANËZ, ISHËM, RRASHBULL DHE KATUND I RI BASHKIA Durrës, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 14512 prot., datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 5, Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katund I Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga

programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas anekseve përkatëse, pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë:

- ✓ Aneksi 1, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative nr.5”
 - ✓ Aneksi 3, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative Sukth”
 - ✓ Aneksi 4, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative Manëz”
 - ✓ Aneksi 5, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative Ishëm”
 - ✓ Aneksi 6, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative Rrashbull”
 - ✓ Aneksi 7, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative Katund i Ri”
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.07.2025



ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

Nr.	EMER	MBIEMR	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	ZONA E TRANSFERIMIT	STRUKTURA
1	RUDINA	CENGU	PRISHJE	SPITALLE	1+1



ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH

Nr.	EMRI	EMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	ZONA E TRANSFERIMIT	STRUKTURA	SUBJEKTE PERFITUESE
1	GENCI	RIKA	PRISHJE	SPITALLE	2+1	PO
2	PAULIN	NDOJA	PRISHJE	SPITALLE	2+1	PO



ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ

Nr.	EMRI	EMRI	KONKLuzioni AKTEKSPERTIZES	ZONA E TRANSFERIMIT	STRUKTURA	SUBJEKTE PERFITUESE
1	SHPETIM	KALIA	PRISHJE	MANEZ	2+1	PO



ANEKSI 5. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM

Nr.	EMRI	EMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	ZONA E TRANFERIMIT	STRUKTURA	SUBJEKTE PERFITUESE
1	ALFRED	BUSHAJ	PRISHJE	SPITALLE	1+1	PO
2	MUHARREM	SHEHU	PRISHJE	MANEZ	2+1	PO
3	KOL	CERRI	PRISHJE	SPITALLE	1+1	PO
4	KUJTIM	SALIA	PRISHJE	ISHEM	3+1	PO



ANEKSI 6. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL

Nr.	EMRI	EMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	ZONA E TRANSFERIMIT	STRUKTURA	SUBJEKTE PERFITUESE
1	PERPARIM	MULLAJ	PRISHJE	PALLATI HYSEN MYSHKETA 30	1+1	PO



ANEKSI 7. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI

Nr.	EMRI	EMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	ZONA E TRANSFERIMIT	STRUKTURA	SUBJEKTE PERFITUESE
1	SHKELQIM	LACI	PRISHJE	SPITALLE	1+1	PO






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 54₇ prot.

Durrës, më 24 . 07 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.43 datë 23.07.2025, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 5, Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katund i Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

